



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rr. "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

"Halit S. Rama" B.I. Komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson z. Halit Rama, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810445941 perkatesisht, (në vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

SANIMI I DËMËVE DHE IZOLIMI KOMPLET I KULMIT TË PALESTRËS SPORTIVE NË ISTOG

| | |
|-------------------------|---------------------------------|
| <i>Nr. I prokurimit</i> | <i>633-20-1203-5-2-1/ C 337</i> |
| <i>Nr. I brendshëm</i> | <i>633 / 020 / 011/ 521</i> |

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

SANIMI I DËMËVE DHE IZOLIMI KOMPLET I KULMIT TË PALESTRËS SPORTIVE NË ISTOG

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit **SANIMI I DËMËVE DHE IZOLIMI KOMPLET I KULMIT TË PALESTRËS SPORTIVE NË ISTOG** është: 67.648,30 € dhe me fjalë:

/Gjashtëdhjetëeshtatë mijë e gjashtëqindëkatërdhjetë tetë e 30/100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për

pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:
"Halit S. Rama" B.I.

| | | | |
|--------------------|---|--------------------|---|
| Emri: | Zizë Bujupaj | Emri: | Halit Rama |
| Pozita: | Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit | Pozita: | D r e j t o r |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 02.07.2020 | Data: | 02.07.2020 |
| Vu la |  | Vu la |  |

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|-----------|---|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë: GJUHA SHQIPE. |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % E VLERES SE KONTRATES ME VLEFSHMERI 30 DITË, ME GJATE SE REALIZIMI I KONTRATES. |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite. |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimi, pas nënshkrimit te kontrates</i> |
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 30 DITË. |
| Dëmet e likuiduara | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës. |
| Regjistri i punës | 20.1 | Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i> |
| Parapagimi | 26.1 | Shuma e Parapagimit është: SKA |
| Shkaqet kompensim për | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës. |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve është: 365 ditë (ME SIGURIM TE CILESISE) |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata. |

SALLA E SPORTIT ISTOG

| EMRI I PUNËS | | | | | |
|--------------------------------|--|----------------|----------|--------|-----------------|
| Nr | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi | Totali [€] |
| 1 | PUNET PERGADITORE | | | | |
| 1.1 | Pastrimi i pergjithshem i kulmit nga mbeturinat eventuale, ekzistues dhe depertimi eventual i olluqeve te bllokuara. | paush. | 1 | 200.00 | 200.00 |
| 1.2 | Montimi i Skeleve ne Objekt paraprakisht per punet e demontimit si dhe punimlt te shtreses se hidrotermoizolimit te kulmit | m ² | 2,000.00 | 0.30 | 600.00 |
| 1.3 | Demolimi i pikoreve te demtuara te dritareve. | m' | 450 | 0.70 | 315.00 |
| 1.4 | Shtangimi dhe fiksimi i llamarinave ekzistues ne rrafshin e kulmit te cilat levizin dhe nuk jane te shtanguara. | m ² | 1,900.00 | 0.60 | 1,140.00 |
| 1.5 | Largimi i perkoshem i rrufepritesit nga kulmi si dhe kthimi i tije ne vendin e njejet pas perfundimit te punimeve (Nese parashihet demtimi i tije te zevendesohet me rrufeprites te ri) | Paush. | 1.00 | 550.00 | 550.00 |
| 1.6 | Largimi i perkoshem i kablove te internetit, rrymes etj nga kulmi si dhe kthimi i tyre ne vendin e njejet pas perfundimit te punimeve. (Nese eshte e nevojshme te furnizohen kablo te reja) | Paush. | 1.00 | 150.00 | 150.00 |
| 1.7 | Demolimi i pikores nga muri i parapetit . (Demolimi duhet te behet aty ku konsiderohet si e demtuar) | m' | 368.00 | 0.60 | 220.80 |
| 1.8 | Demolimi i llamarines se demtuar ekzistuese ne murin e parapetit (vetem pjeset e demtuara sipas udhezimeve te organit mbikqyres gjegjesisht projektantit) | m ² | 500.00 | 0.60 | 300.00 |
| TOTAL PUNET PERGADITORE | | | | | 3,475.80 |



| | | | | | |
|--|---|----------------|----------|-------|------------------|
| 2 | PUNET E HIDRO DHE TERMOIZOLIMIT HORIZONTAL | | | | |
| 2.1 | Aplikimi i termoizolimit ne trashesi sipas detalit t=9 cm (4+5) nga XPS i vendosur mbi llamarin ne pergjithesi sipas detalit ne shtese te ketij pershkrimi teknik.. Pllakat e termoizolimit duhen te vendosen me kujdes dhe lidhjet ndermjet pllakave duhen te jene pa devijime dhe pa thyerje (demptim) teheve. Shtresa termoizoluese (si shtrese mbeshetese e HI) duhet te i plotesoj keto kushte dhe karakteristika teknike : Densiteti rreth > 30 kg/m ³ Rrezistenca ne shtypje > 150 kPa | m ² | 1,900.00 | 9.90 | 18,810.00 |
| 2.2 | Aplikimi i shtreses ndarese ndermjet termizolimit dhe hidroizolimit me gjeotekstil 300 gr/m ² | m ² | 1,900.00 | 1.20 | 2,280.00 |
| 2.3 | Furnizimi dhe montimi membranesh hidroizoluese shumeshtresore sintetike ne baze PVC, Sikaplan 15 G, ne pjeset horizontale (sipas ramjes se kulmit), e perforcuar me rrjete qelqi. Shtresa hidroizoluese ne trashesi 1.5 mm vendoset mbi shtrese te gjeotextilit 300 gr/m ² , fiksohet per nenkonstrukcion sipas llogaris " Wind load " kurse tegelat saldohen me ajr te nxehte ne baze te instruksioneve te prodhuesit. Membrana hidroizoluese duhet qe te i plotesoj te gjitha kushtet dhe specifikat teknike sipas pershkrimit teknik te projektit . | m ² | 1,900.00 | 17.50 | 33,250.00 |
| 2.4 | Furnizimi dhe montimi i ujembledhesve vertical / horizontal sipas pozicioneve te depertimeve ekzistuese te ujit nga kulmi (min. 1 cope ne 50 m ² te kulmit) .Ujembledhesat duhet qe te montohen ne pergjithesi sipas instruksioneve te prodhuesit organit mbikqyres.. | cope | 15 | 65.00 | 975.00 |
| 2.5 | Furnizimi dhe montimi i ventilueseve te kulmit (min. 1 cope ne 100 m ² te kulmit) .Ventiluesit duhet te montohen ne pergjithesi sipas instruksioneve te prodhuesit dhe organit mbikqyres. | cope | 20 | 55.00 | 1,100.00 |
| 2.6 | Furnizimi me material dhe perpunimi i perfundimeve te membranesh hidroizoluese PVC rreth dritareve me Membrane Likuide njekomponentne ne baze poliuretani Sikalastic 614 ose e ngjajshme e cila aktivizohet ne kontakt me lageshtine. Membrana Likuide duhet qe : Te kete rezistence te larte ndaj ndikimeve te rrezeve Ute kete rezistence standarde ndaj ndikimeve te ambientit Rrezistence te larte ne ndikime mekanike Fleksibilitet te larte ne temperature te uleta dhe t'i plotesoj Standardet sipas EN ISO 527-3 Gjeresia e zhvilluar min 0.5 m/1m | m' | 450 | 1.50 | 675.00 |
| TOTAL PUNET E HIDRO DHE TERMOIZOLIMIT | | | | | 57,090.00 |
| 3 | PUNET E LLAMARINES | | | | |
| 3.1 | Furnizimi i gjithe materialit te nevojshem dhe punimi i pikoreve te plastifikuara (Ose i ngjajshem)dimensionet dhe ngjyra e njeje si ajo ekzistuese ne pergjithesi sipas detalit per punim dhe udhezimeve te Organit mbikqyres , gjegjesisht Projektantit . | m ² | 200 | 2.80 | 560.00 |



| | | | | | |
|---------------------------------|--|----------------|-----|----------|-----------------|
| 3.2 | Furnizimi i gjithë materialit të nevojshëm dhe punimi i pikoreve të dritareve, dimensionet dhe ngjyra të jetë e njëjet si ajo ekzistuese në përgjithësi sipas detalit dhe Organit mbikqyres, gjegjësisht projektantit. | m' | 200 | 2.80 | 560.00 |
| TOTAL PUNET E LLAMARINES | | | | | 1,120.00 |
| 4 | PUNET TJERA | | | | |
| 4.1 | Furnizimi me material dhe montimi i sandwich panelit t=10 cm në pjesën e kulmit ku është e demtuar. Sandwich Panelli duhet që të i plotësojë të gjitha kushtet dhe specifikat teknike sipas përshkrimit teknik të projektit, si dhe në cmime duhet të parashihet gjithë materiali i nevojshëm për montim. | m ² | 100 | 15.00 | 1,500.00 |
| 4.2 | Furnizimi me material dhe montimi i llamarines së plastifikuar rreth sandwich panelit në pjesën e kulmit ku është e demtuar. Llamarina e Plastifikuar duhet që të i plotësojë të gjitha kushtet dhe specifikat teknike sipas përshkrimit teknik të projektit, si dhe në cmime duhet të parashihet gjithë materiali i nevojshëm për montim. | m' | 85 | 12.50 | 1,062.50 |
| 4.3 | Furnizimi dhe montimi i xhamave për DRITARE dhe DYER të demtuara nga ererat - me profile kompozite pvc, profili 82-92mm STRONG 3, me sharniera ROTO. Dritaret do të jenë me xham sigurie 331/16/331, mbushje me argon. Të aplikohet sistem katershtresor mbrojtës SIKKENS me impregnim të thellë. | Paush. | 1 | 1,500.00 | 1,500.00 |
| 4.4 | Punë tjera të cilat nuk janë paraparë me projekt. | Paush. | 1 | 1,900.00 | 1,900.00 |
| TOTAL PUNET E TJERA | | | | | 5,962.50 |



REKAPITULIMI

| | | | | |
|----|---|--|----------|------------------|
| 1. | PUNET PERGADITORE | | | 3,475.80 |
| 2. | PUNET E HIDRO DHE TERMOIZOLIMIT | | | 57,090.00 |
| 3. | PUNET E LLAMARINES | | | 1,120.00 |
| 4. | PUNET TJERA | | | 5,962.50 |
| | TOTAL RENOVIMI I KULMIT NE SALLEN E SPORTIT ISTOG me te gjitha ngarkesat | | € | 67,648.30 |

